VENDIM
Nr.857, datë 21.10.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË KONISPOL, TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Konispol, të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Konispol të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr.662, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të bashkisë Konispol, të qarkut të Vlorës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Konispol për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Konispol Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
5-10	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
13, 14	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore, historike e sportive	Në pronësi
23-26	Varreza publike	Në pronësi
27, 28, 29	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
30-36	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
39	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
40-51	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
108	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi